



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 7

Prishtinë, më 25.2.2015, ora 10,00 dhe 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Adem Salihaj, Shaip Muja, Murat Hoxha, Salih Salihu.

Mungoi : Velimir Rakiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 16.2.2015,
3. Takimi i Komisionit me Kryeshefin e Agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.2.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Takimi i Komisionit me Kryeshefin e Agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë

Kryetari në fillim falënderoi për pjesëmarrjen e të ftuarve nga AUV z. Naser Krasniqi, Izet Imeri dhe Naim Delijaj dhe sqaroi shkurtimisht për shqetësimin e komisionit lidhur me kualitetin e miellit të importuar në Kosovë, ndaj i luti fillimisht të njoftojnë komisionin për këtë çështje, në mënyrë që të vazhdoi pastaj puna me pyetje dhe përgjigje.

Naser Krasniqi tha se AUV është autoritet më i lartë në sigurinë ushqimore, shëndetin publik të njerëzve, shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, kontrollon produktet me origjinë bimore dhe shtazore nga ferma në tavolinë si dhe kushtet higjieno sanitare. AUV nuk zhvillon politika bujqësore por është staf profesional dhe zbaton sigurinë ushqimore ku çdo produkt që hynë dhe prodhohet në Kosovë i nënshtrohet kontrollit me kritere dhe standarde ndërkombëtare në bazë të ligjit të ushqimit, planit të kontrollave zyrtare dhe planit të mostrimit. Çdo grurë që hyn në Kosovë është i sigurt, i kontrolluar dhe i mostruar nga inspektorati i kufirit ku pas kontrollit të dokumentacionit, kontrollit fizik dhe në bazë të dyshimeve të analizës së riskut, planit të mostrimit del se çdo e gjashta maune u është nënshtrohet testit laboratorik në Institutin bujqësor të Pejës, të gjitha ngarkesat kanë qenë të pajisura me fito certifikata për grurë merkantil gjë e cila mund të dokumentohet, në bazë të analizave nga parametrat fiziko/kimik, metalet e rënda, lagështia, pesha hektolitare, proteina, gluteni dhe nga të gjitha këta parametra gruri i ka plotësuar kushtet cilësore për bluarje mielli. Nuk është prezantuar asnjë rast importit të grurit për ushqim për kafshë (sqaroi : Inspektorati fitosanitar i kufirit gjatë procesit të kontrollit nuk ka qasje në dokumentacionin doganor që përgatitet nga ana e agjentëve doganor për doganën si dhe dokumentacioni i cili përgatitet nga ana e doganës për importuesin). Gjatë vitit 2014 janë importu grurë merkantil për bluarje në sasi prej 36.474 ton ku nga inspektorët fitosanitar janë dhënë për plotësim 300 aplikacione, pra për analiza fiziko kimike dhe metale të rënda janë marr 70 mostra kampion të dërguara për analizë në Institutin e Pejës, ndërsa në vitin 2015 janë importu 429 maune grurë merkantil ku prej tyre ju kanë nënshtrohet analizave laboratorike dhe janë krijuar 9 kampione mostrash dmth çdo e gjashta është mostru. **Izet Imeri** shtoi se inspektimi i grurit bëhet në bazë të dispozitave ligjore , ligjit për ushqimin dhe atë për doganat, gruri bënë pjesë në produktet bimore natyrore L-02 ku zbatohet ligji për mbrojtjen e bimëve në bazë të tre kodeve. Mostrimi kryhet në bazë të planit dhe programit të sektorit fitosanitar dhe mostrat e marra për analizë dërgohen në IBK për analiza fiziko/kimike, kurse analizat në mykotoksina (Alfatoxin) janë kryer në laboratorin e AUV ndërsa superanalizat kryhen në laboratorët ndërkombëtar të BE. Në vazhdim zyrtar të AUV sqaruan procedurat e inspektimeve duke filluar me certifikatën fitosanitare e cila poçes nuk ekziston, malli kthehet, përndryshe fillon me shiqimin vizual, hapje të maunës etj dhe shumë detaje tjera, formimi i mostrave, detektimi i radioaktivitetit, lagështia e cila tregon se sa është ruajt gruri, dhe në fund bllobohen maunat. Në bazë të rezultateve të analizës merret vendimi inspektiv 1. Refuzim apo 2. Ndryshim destinacioni.

Kryetari falënderoi për njoftimin dhe para se të fillojnë pyetjet e anëtarëve të komisionit parashit pyetjen e përgjithshme sa mund të jemi të sigurt për miellin që përdorim në Kosovë, për çka zëvendës kryeshefi z. Krasniqi u përgjigj se siguria është në nivelin e duhur, ndërkaq **Shaip Muja** në fillim tha se ky raportim është dashur të bëhet bashkarisht me Ministrin e MB në mënyrë që informimi të jetë sipas rregullave si duhet, kurse për raportim të sotëm nga AUV tha se është joprofesional ngase nuk janë të vërteta pohimet se çdo gjë është në rregull, madje joserioze, ngase nga punimet shkencore të shkenctarve serb rrjedhë e kundërta, që gruri në këtë regjion ka plumb dhe kadmium dhe duke hyrë në Kosovë përmes Devollit apo kujt, sjellë në pyetje shëndetin e popullatës, kësaj dukurie shqetësuese duhet ti themi stop ngase në pyetje është shëndeti i popullatës, madje jo vetëm me miell, ndaj ky informim është dezinformatë. **Lahi Brahimaj** insistoi pse nuk thuhet e vërteta, nëse në Maqedoni mielli përmban 12% proteina pse ky miell nuk shkon në Serbi apo gjetiu por vjen në Kosovë. **Adem Salihaj** propozoi një vizitë në AUV ngase është e quditshme të thuash çdo gjë është në rregull me gjithë këto shqetësime të shfaqura, kjo nuk ndodhë askund pos këtu te ne, sepse ky grurë, e cila dërgohet për analiza në IKBP të paqertifikuar, siç thuhet e kontrolluar, përhapë sëmundjet e ndryshme, ai gjithashtu u interesua a është AUV mjaft e pajisur për ti kryer vet analizat duke mar parasysh që sivjet nga 419 maune janë shikuar vetëm 79 (50 maune me prit një javë pa u shkarkua) dhe a ka importim të grurit që është ma i vjetër se një vit dmth si pjesë e rezervave të një vendi, gjë që kjo po i ndodhë Kosovës. Në fund ai ju uroi zyrtarëve të AUV një saktësi sa më të madhe gjatë importimit të grurit. **Murat Hoxha** pyeti : 1. A ka siguri te mjaftueshme që inspektorët te jene subjektiv ne kontrollet e tyre ne kufi, respektivisht a aplikohet ndonjëherë monitorimi apo

verifikimi i punes se inspektorit që e forcon kontekstin e sigurise që mos te kete subjektivizma me rastin e inspektimit, 2. Me rastin e importit respektivisht hyrjes ne kufi te mallit, a duhet që importuesi ta ketë dokumentacionin e prejardhjes se mallit, pra nga ka ardhë ai mall, më saktë a është importi nga rezervat e Serbise, çështje që aktualisht brengosë dhe krijon dyshime të bazuara te qytetaret dhe, 3. pasi që u potencua disa here që janë bërë edhe kontrolla shtesë laboratorike, cili ishte dyshimi apo arsyeja qe te bëhen këto kontrolla shtesë, dhe a ka pas raste kur te gjitha kontrollat dhe analizat kan dal të dobëta, apo jashtë të lejuarës. Çfarë është berë me ato mallëra apo maune.

Salih Salihu ceku rastin me Shqipërinë e cila ka refuzuar miellin nga Kosova për shkak të mungesës së proteinave (më pak se 12%), që do të thotë se është aspekti i cilësisë së grurit apo ikjes së TVSH, përndryshe nëse vazhdon kështu të gjithë prodhuesit tjerë do të mbyllën (gruri për kafshë nëse përzihet dhe shitet), në fund ai pyeti : 1. A është në pyetje ikja nga TVSH apo 2. Cilësia e dobët e grurit, ngase nëse vazhdohet të importohet gruri i Serbisë më i dobëti në rajon, kjo na sjellë deri te mbyllja e prodhimit vendor, përfundoi. **Emilija Redzepe** insistoi në jovaliditetin e IKBP e cila nuk është e certifikuar, ndaj kërkoi që analizat të dërgohen në institutet tjera.

Shaip Muja ku shkoi mielli që është kthi nga Shqipëria ?

Naser Krasniqi për vërejtjet e bëra kërkoi argumente (Shaip Muja ndërhyri : unë kam fol për punime shkencore jo për gazeta), ngase si tha ai : ne nuk kontrollojmë grurin në Serbi por atë çka vjen nga Serbia (grurin) dhe që hyn në Kosovë, ai tha se i kanë të gjitha mostrat me alfatoxin dhe nuk i kanë mar nëse kanë dalë pozitivë por janë kthi mbrapa, dhe jemi ndër të parët në rajon që kemi zbuluar atë.

Shaip Muja kundërshtoi sepse të parët janë Maqedonia, pastaj Greqia, gjithashtu shtoi se kjo nuk është katastrofë por botimet e AUV nuk janë askund, përfundoi. **Salih Salihu** u bashkëngjiti rreth kultivarit dhe tha pse nuk importojnë nga Sllovenia, ai shfaqti dyshimin edhe më të madhë pasi që **Shaip Muja** shpërndau shkresën e punimit shkencorë të cekur nga Serbia/nga katër punëtorë shkencorë. Në pyetjen më detale të **Shaip Mujës**, z. Krasniqi tha se ata nuk mundën të klasifikojnë sakt për cilin operator bëhet fjalë por çdo maune kontrollohet dhe kjo dihet nga një analizë, përndryshe nuk mundën të kontrollojnë rezervat e një vendi. Në vazhdim gjithashtu edhe Lahi Brahimaj, Murat Hoxha dhe Adem Salihaj shfaqën dyshimin në kapacitetin për analiza të AUV. Ndërsa **Kryetari** ripërsëriti pyetjen e grurit nga Shqipëria, ku ndodhet (mbeti) ajo ?

z. Krasniqi potencoi se në BE nuk është rregullë strikt që mielli të përmban 12% proteina por ajo mund të shkoi deri 9%.

Salih Salihu por është përcaktues i çmimit. Ai gjithashtu potencoi ngjyrën e zezë të bukës në Kosovë , e cila është mjaft diskutabile dhe me dyshime. **Naim Delijaj** po profesor, por ky dyshim ka filluar të hiqet, pasi ka hy në fuqi ligji për pasurimin e miellit me acid folik dhe vetdijimit të popullit. **Salih Salihu** por ky ligj nuk po implementohet. Ai prapë pyeti : çka është në pyetje, ikja nga TVSH apo cilësia e grurit. **Shaip Muja** megjithate konstatoi se pas gjitha këtyre bisedave për proteina ku ato përfundojnë dhe si, mbetet pyetja, ne në Kosovë a ushqehemi me bukë cilësor, ndërsa **Lahi Brahimaj** a kemi miell të shëndetshëm apo grur të kafshëve. **Naser Krasniqi** pohoi se lidhur me këtë kanë shfrytëzuar një laborator të akredituar në Itali, por potencoi se AUV nuk mundet me ditë atë çka kontrollojnë doganat, ngase këta punojnë në bazë të certifikatës fitosanitare, nëse nuk besoni, formojeni ju një komision dhe ejani në verifikim.

Komisioni vendosi që të hënën një grup të vizitoi Doganat e Kosovës.

Të nderuar anëtarë të komisionit, bashkëngjisim procesverbalit shtesën nga z. Muja, të cilin edhe ju mund të vlerësoni se janë diskutuar këto fakte.

PLOTËSIMI NGA SHAIPI MUJA : AUV përkatësisht zyrtarët prezent në mbledhje theksuan se analizat e miellit janë bërë që vitin e kaluar, pasi që ne paraparakisht pyetëm ku janë dërguar mostrat në superekspertizë dhe sa kohë duhet të ruhen mostrat sipas ligjeve ndërkombëtare, pastaj kemi kërkuar ti bëjmë shkresë laboratorit Italian, ata thanë

se i kanë bërë analizat vitin e kaluar dhe si laborator duhet ti ken ruajtur mostrat, pastaj ne ti vizitojmë dhe tju marim mostrat për ti dërguar në ndonjë laborator tjetër evropian për të barazuar analizat nga laboratorët e Kosovës dhe punimet shkencore nga Serbia (të shpërndara në mbledhje-në gjuhën angleze) të cilat kanë zbardhë ekzistimin e plumbit dhe kadmiumit në grurë. Dërgimi i analizave për Itali nga kjo datë (15.2.2015) vërteton që AUV ka gënjyer kur deklaruan se pas analizave të Pejës dhe një laborator privat nuk ju kemi besuar dhe i kemi dërguar për superekspertizë në Itali gjatë vitit 2014. Incizimet në mbledhje do ti faktojnë këto gjëra si dhe ju lus që punimin shkencorë të shpërndarë të përktheni në gjuhën shqipe për ti shpërndarë anëtarëve të komisionit. Sot ne po kërkojmë sa vite, çfarë cilësie të grurit është futur në Kosovë, nga kush dhe nga cilat shtete, poashtu edhe misri, si janë klasifikuar operatorët në Kosovë nga AUV, dhe kush i ka të akredituara analizat për cilësinë e grurit dhe miellit në Kosovë, sepse laborator i në Pejë mund të jetë i licencuar por jo i akredituar për analiza të tilla. Besoj se ka shumë gjëra për tu zbardhur.

SHTESË NGA STAFI : Në dy shkresat e prezantuara nga zyrtarët e AUV në mbledhjen e fundit të komisionit, të cilat do të shpërndahen anëtarëve të komisionit, nuk bëhet fjalë në asnjë vend për analiza në Itali.

Lidhur me shkresën e shpërndarë nga z. Muja për të pranishmit, punimi shkencorë në gjuhën angleze, ne stafi nuk kemi pas autorizim nga Komisioni apo Kryetari, për të shpërndarë anëtarëve të komisionit dhe për ta përkthyer.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka